Kronikë

Lezhë/ Ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes dhe mbante armë pa leje në shtëpi, arrestohet 37-vjeçari

Një 37 vjeçar është vendosur në pranga pasi ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes dhe mbante armë zjarri pa leje në banesë

Arma e sekuestruar

Redaksia
27 Tetor, 11:05 | **Përditesimi: 27 Tetor, 11:23**

Share

Lezhë-Një 37 vjeçar është vendosur në pranga pasi ushtronte dhunë ndaj bashkëshortes dhe mbante armë zjarri pa leje në banesë.

Arrestimi i tij u krye nga uniformat blu të Lezhës në bashkëpunim me Forcat Shqiponja.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 1 armë zjarri pistoletë dhe municion luftarak.

LEXO EDHE:
Aksident i rëndë në superstradën Lezhë-Laç, një i vdekur dhe një i plagosur! Shkak dyshohet parakalimi i gabuar i viktimës, u përplas me 2 mjete! Ende i paidentifikuar (VIDEO)

> *"Shërbimet e Komisariatit të Policisë Lezhë menjëherë pas njoftimit të marrë për një rast dhune në familje ku bashkëshorti dhunonte bashkëshorten dhe mbante armë zjarri pa leje, menjëherë kanë organizuar punën për parandalimin e përshkallëzimit të dhunës dhe kapjen e autorit.*
>
> *Në bashkëpunim me Forcën e Posaçme "Shqiponja" të DVP Lezhë, bënë kapjen dhe arrestimin në flagrancë të shtetasit M. G., 37 vjeç, banues në Lezhë.*
>
> *Në vijim të veprimeve policore për këtë rast, është kryer kontroll në banesën e shtetasit të arrestuar, ku Policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale armë zjarri pistoletë e municion luftarak", informoi sot policia.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme për veprat penale "Dhuna në familje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

Xh.K/Shqiptarja.com

TAG: Lezhe | dhune ne familje | arme zjarri

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A e forcojnë besimin tuaj tek SPAK arrestimet e Metës e Çyrbjas?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Qëllohet me armë ndaj një personi në Lezhë, s'ka të lënduar! Policia shoqëron shënjestrën e sulmit, po merret në pyetje (VIDEO)
27 Tetor, 19:44

Lezhë/ Pallati 10-katësh përfshihet nga flakët, asfiksohen 3 zjarrfikës dhe një banor, dërgohen në spital! Shkak zjarri në gjeneratorin e katit përdhes (VIDEO)
27 Tetor, 18:44

Lezhë/ Përleshje për pronësi mes 2 familjeve në Torovicë, babë e bir plagosin rëndë me kosore 47-vjeçarin! Njëri në kërkim, tjetri do shoqërohet pas mjekimit (VIDEO+EMRAT)
27 Tetor, 17:45

Vaksina anti-grip, infermieri në Lezhë u ofron të moshuarve shërbimin në shtëpi
Elvis Hila
27 Tetor, 15:18

Mirditë/ Aksident i rëndë në punë, i riu goditet nga kova e fadromës, humb jetën (EMRI+FOTO)
27 Tetor, 14:00

Hajdutët nuk kursejnë as Skënderbeun! Memoriali i tij mbetet në terr, vidhen për herë të tretë kabujt elektrik në zonën arkeologjike të Lezhës
Elvis Hila
26 Tetor, 13:05

Tetori i kamperave/ Turistët e huaj tregojnë në 'Report TV 'si zbuluan oazin e qetësisë, pranë detit e malit
Elvis Hila
26 Tetor, 12:09

Dhunoi nënën, arrestohet 48-vjeçari në Tiranë
25 Tetor, 13:02

Në kërkim ndërkombëtar, dërgohet për gjykim 40-vjeçari! Bëri thirrje në rrjetet sociale për heqjen e pllakatit të Erdogan në Laç: S'mund të vendosen simbole të një vendi që na ka pushtuar
Elvis Hila
25 Tetor, 09:09

Lezhë/ 30-vjetori i entit botues 'Fishta', Frano Kulli: Botuam të parët kolanën e veprës së At Gjergj Fishtës
Elvis Hila
24 Tetor, 15:51

Motori përplas për vdekje 75-vjeçaren në Lezhë
24 Tetor, 13:45

Lezhë/ Çmimet letrare "At Gjergj Fishta", vlerësohen Rudolf Marku, Marash Mirashi, Stefan Çapaliku dhe Fatmir Toçi
Elvis Hila
23 Tetor, 17:11

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje